



**Republika e Kosovës
Komuna e Drenas(Gllogoc)
Kuvendi i Komunës**



02 Nr. 400/01-57195 dt. 22.11.2023

Bazuar në nenin 11,12 dhe 40 të Ligjit Nr Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregulloren për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Nr. 12-320-19338, dt. 7.4.2017, Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për ndarjen e subvencioneve Nr.400/01-18380 e datës 27.4.2022, si dhe Kërkesës të Qendrës për Promovimin e të Drejtave të Grave, Nr.01-070/01-55987, të datës 14.11.2023, për Kuvendin e Komunës, Kuvendi i Komunës së Drenasit (Gllogoc) në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 22.11.2023, miratoi këtë:

V E N D I M

Për mbështetje financiare

Neni 1

Miratohet kërkesa e Qendrës për Promovimin e Drejtave të Grave, Nr. 01-070/01-55987, të datës 14.11.2023, për ndihmë financiare për këtë qendër, në shumën prej 3,000.00 euro, nga kategoria e shpenzimeve: Subvencione dhe transfere.

Neni 2

Mjetet financiare të aprovuara sipas këtij Vendimi do të paguhen nga pozicioni, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, të parapara me buxhetin e vitit 2023.

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari

A R S Y E T I M

Pranë Zyrës së Kryetarit, është adresuar kërkesa e Qendrës për Promovimin e Drejtave të Grave, Nr. 01-070/01-55987, të datës 14.11.2023, ku është parashtruar nevoja për mbështetje financiare për këtë qendër.

Komuna e Drenasit brenda kompetencave të saja ligjore dhe buxhetore, e ka të rregulluar këtë çështje përmes Rregullores së brendshme komunale - Rregulloren për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve Nr. 12-320-19338 dt. 07.04.2017 si dhe rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për ndarjen e subvencioneve Nr.400/01-18380 e datës 27.04.2022 e cila parasheh se Komuna subvencionon në formë të përkrahjes financiare OJQ-të, sipas kriterëve të përcaktuara me të njëjtin dokument/rregullore, ku edhe duke u bazuar në këtë, përmes këtij dokumenti, propozohet që në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe brenda kompetencave, Kryetari propozon të aprovohet kërkesa e cekur më lartë.